



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4253/11 Prot

Tiranë, më 22.6 2022

UDHËZIM

Nr. 15, Datë 22.6 2022

PËR

NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 19.02.2018, "PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 19.02.2018, "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", të bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Në fund të pikës 2, shtohet:

"Formimi i numrit të matrikullimit, për studentët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", që japin akses në programet e studimit të ciklit të dytë "Master" në fushën e mësuesisë, të cilët nuk e plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, është sipas shtojcës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Numri i matrikullimit, për këtë kategori studentësh identifikohet nga kodi i ciklit të studimit me shkronjën V, e cila nënkupton mos lejimin për regjistrim, nga institucionet e arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë dhe mos matrikullimin nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në rast regjistrimi."

b) Shtojca nr.1, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij udhëzimi, zëvendësohet me shtojcën nr. 1 me të njëjtin numër.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit dhe Sportit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR
EVIS KUSHI



Shtojca nr.1: Për përcaktimin e kodit të ciklit të studimit

| Cikli i studimit | Shënime | Forma e studimit | | Kodi i ciklit |
|-----------------------|--|------------------|----|---------------|
| | | | | |
| DP/CP | Programe studimi me karakter profesional (1 ose 2 vjet) | KP | KZ | Q |
| “Bachelor” | Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë | KP | | A |
| “Bachelor” | Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë | KP | | V |
| “Master i shkencave” | Cikli i dytë i studimeve, “Master i shkencave”/”Master i arteve” | KP | | B |
| “Master profesional” | Cikli i dytë i studimeve, “Master profesional” me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur | KP | KZ | G |
| PISCD | Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë 5 ose 6 vjeçar, me kohë të plotë | KP | | E |
| “Master ekzekutiv” | “Master ekzekutiv” cikli i tretë | KP | KZ | K |
| Specializim Afatgjatë | Studime specializuese afatgjata, cikli i tretë | | | M |
| Doktoratë | Doktoratë, cikli i tretë | | | N |